



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

K. Bogdani

**PROJEKTIVENDIM**

Nr 1820, Datë 14.2. 2023

**Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për financimin e ofrimit të shërbimit të përkujdesit social në bashki**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.49/3, datë 11.01.2023 “Transferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në bashki”, Kryetari i Bashkisë paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkiak,

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2023 në shumën 1,172,000 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën 49/3, datë 11.01.2023.

2/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 1,172,000 lekë lekë Fondi do të përdoret për:
  - Paga në shumën 542,000 lekë; Sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën 90,000 lekë.
  - Mbështetje ekonomike për fëmijët me aftësi të kufizuara në shumën 500,000 lekë;
  - Për trajnimin e stafit të projektit në shumën 40,000 lekë;

Këto shpenzime do të bëhen për projektin “Tungjateta Jetë” gjatë vitin 2023.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr 1468 prot

Lezhë më, 3 / 2 / 2023

MIRATOI  
KRYETARI  
Pjerin Ndreu

**LËNDA:** Kërkesë për përdorimin e fondit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KËTU**

Në bazë të shkresës me nr .4957 Prot, datë 30.12.2022 me qëllim mundësimin e vazhdimësisë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar vijimin e financimit të vitit të katërt të ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror “Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar, Tungjatjeta jetë” në Bashkinë Lezhë në kuadër të fondit social për vitin 2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të financojë vijimin e ofrimit të shërbimit në vitin e katërt në masën 30% të kostos në vlerën 1,172,000 lekë.

Kërkojmë miratimin e fondit që të përdoret për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sic është përcaktuar në fishën e buxhetit bashkëlidhur.

Bashkangjitur gjen dokumentat përkatës. (shkresa e ministrisë për miratimin e fondit, preventivin e shpenzimeve fish buxhetin, relacionin përkatës , formularin e kostos së shërbimit).

**Drejtori i Shërbimit dhe Kujdesit Social**

**Marte Fetaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Lezhë, më: 31/01/2023

## RELACION

**Projekti:** Shërbimi lëvizës “Tungjatjeta... Jete” për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë.

Shërbimi lëvizës “Tungjatjeta... Jete” për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë është një projekt i fituar referuar shkresës nr.4993/3, datë 18.09.2019, në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime të programit të fondit social thirrje e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Ky është një program social që ofron shërbime të specializuara në shtëpi për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, në zona të thella të vendit.

Ky program Filloi të zbatohet për herë të parë në Bashkinë Lezhë në prill të vitit 2020. Pamundësia ekonomike, largësia nga qendrat, mungesa e transportit apo mentaliteti janë vetëm një pjesë e vogël mes një liste të gjatë faktorësh se përse fëmijët nuk merrnin dot shërbimet e specializuara për të cilat kishin nevojë.

Në këto rrethana Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara filloi shërbimin duke dërguar ekipe specialistësh për të vizituar fëmijët dhe familjarët në banesat e tyre dhe për të ofruar terapi për ta sipas diagnozës së tyre dhe shërbim social për familjet. Fëmijët ndiqen hap pas hapi në bazë të planeve individuale të zhvillimit që hartohen për ta. Gjithashtu punohet shumë ngushtë me prindërit për integrimin e fëmijëve të tyre apo me probleme të tjera sociale që ata kanë.

Shërbimi lëvizës ofron terapi për 45 fëmijë (32 djem dhe 13 vajza) me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në zona të thella të Lezhës. Njesia lëvizëse ofron shërbim një herë në javë në shtëpinë e çdo fëmijë i cili/ e cila përfiton mesatarisht një seancë në javë, ku çdo seancë zgjat 60 minuta, nga të cilat 45 minuta specialisti ia kushton fëmijës dhe 15 minuta aftësimin të prindit për të realizuar ushtrime të thjeshta në vijim të terapisë. Fëmijët kanë marrë terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi një herë në javë. Prindërit e tyre gjithashtu janë mbështetur duke punuar ngushtë punonjësit sociale me ta. Shërbimi Lëvizës ofron edhe ndihmë materiale dhe mbështetje psiko-sociale edhe për familjen e fëmijës me aftësi të kufizuara.

Gjatë këtyre tre viteve kanë marrë terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi një herë në javë 45 fëmijë me aftësi të kufizuara (32 djem dhe 13 vajza). Ndërkohë familjarët e fëmijëve kanë marrë shërbim social, ku përfshihet këshillim, menaxhim dhe monitorim të rasteve të familjeve që kanë probleme ekonomike dhe sociale, bashkëpunim dhe referim në institucione



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

të tjera për marrjen e shërbimeve shtesë, hartime të Planeve të Zhvillimit të Familjeve dhe ndërhyrje në ndërgjegjësim të komunitetit.

Secili specialist ka përgatitur plane dhe raportet për secilin fëmijë, ku përfshihen; vlerësimet e punonjësës sociale, vlerësimet e psikologes, vlerësimet biopsikosociale të përgatitura nga i gjithë ekipi, planet e zhvillimit individual, planet e zhvillimit të familjes, planet dy mujore për cdo fëmijë, kartela logopedike, fizioterapike etj. Në bazë të këtyre vlerësimeve dhe planeve, secili specialist e ka patur më të thjeshtë organizimin e punës dhe terapitë e shërbimet për secilin fëmijë/familjarë.

Gjatë këtyre tre viteve kemi bashkëpunuar me Drejtorinë Arsimore duke organizuar takime sensibilizuese e ndërgjegjësuere me mësues ndihmës, logoped, psikolog e punonjës social të shkollave të ndryshme duke ndarë planet e punës në mënyrë që fëmija të ndjekë të njëjtën linjë terapie.

Gjithashtu bashkëpunim shumë i ngushtë ka qënë edhe me çerdhet e kopshtet e Bashkisë Lezhë tek të cilët kemi referuar raste të fëmijë që kanë patur të domosdoshëm frekuentimin e kopshtit, por gjithashtu takime sensibilizuese me edukatorët duke diskutuar rreth bashkëpunimit me institucionet, me prindërit e fëmijëve kryesisht të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Bashkëpunimi ka qënë shumë i mirë dhe efikas.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe me partnerë të tjerë në zonë, specialistët e shërbimit lëvizës vazhdojnë të mbajnë takime me infermierët e zonës dhe mjekun e familjes, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së fëmijëve dhe familjarëve të tyre.

Gjatë muajit qershor 2022 ekipi i projektit ka realizuar dy aktivitete argëtuese në bregdetin e Shëngjinit. Aktiviteti kishtë të përfshirë 10 prind dhe 10 fëmijë dhe kishtë si qëllim arëtimine fëmijëve me lojra zhvilluese, por jo vetëm, e gjithashtu angazhimine prindërve në lojra grupi ku lejonte bashkëbisedimin e prindërve me njeri-tjetrin për të ndarë secili përvojat e tij.

Prindërit vazhdimisht kanë shprehur kënaqësi dhe optimizëm për këtë projekt që po implementohet për herë të parë. Ata shprehin nevojën e vazhdimësisë të këtij projekti pasi kanë parë rezultate të arrira tek fëmijët e tyre. Tashmë janë më të informuar në lidhje më marrjen e shërbimeve, të drejtave të tyre dhe detyrimeve që kanë institucionet shtetërore për fëmijët me aftësi të kufizuar.

**Drejtori i Shërbimit dhe Kujdesit Social**

**Marte Fetaj**



**POLITIKA E PROGRAMIT**

**Programi Buxhetor Afatmesë 2023-2025**

**Programi 10430**

**Përshkrimi i Programit**

Ky program lidhet me :  
Ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre.

|             |  |   |              |              |             |
|-------------|--|---|--------------|--------------|-------------|
| <b>1</b>    | <b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>                              | Ofrimi i shërbimit lëvizës të specializuar për 50 (32M/18F) fëmijë me aftësi të kufizuar që nuk aksesojnë dot qendrat e ofrimit të shërbimeve |              |              |             |
|             | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi                            | <b>2022</b>   | <b>2023</b>  | <b>2024</b>  | <b>2025</b> |
|             |  | <b>Buxheti</b>  | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> |             |
|             | Ofrimi i terapive të fëmijëve me aftësi të kufizuar.                 | 45  | 50           | 55           | 60          |
|             | Aktivitetet ndërgjegjëse në komunitet                                | 20  | 25           | 30           | 35          |
|             | Shërbime psiko-sociale me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar | 60  | 70           | 80           | 90          |
| <b>1.1.</b> | <b>Objektivi i Politikës së Programit</b>                            |   |              |              |             |
|             | Treguesit e Performancës për Objektivin                              |   |              |              |             |
|             | Rritja e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar                | 45  | 50           | 55           | 60          |
| <b>1.2.</b> | <b>Objektivi i Politikës së Programit</b>                            |   |              |              |             |
|             | Treguesit e Performancës për Objektivin                              |   |              |              |             |
|             | Rritja e nr. të përfituesve në aktivitetet ndërgjegjëse në komunitet | 120   | 150          | 160          | 170         |
| <b>1.3.</b> | <b>Objektivi i Politikës së Programit</b>                            |   |              |              |             |
|             | Treguesit e Performancës për Objektivin                              |   |              |              |             |
|             | Rritja e nr. të prindërve në marrjen e shërbimit social.             | 45  | 50           | 55           | 60          |

**SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT**

**Programi Buxhetor Afatmesë 2023-2025**

**Programi 10430**

|               |   |  |              |              |              |
|---------------|---|--|--------------|--------------|--------------|
| <b>1.1.</b>   | <b>Objektivi i Politikës së Programit</b> | Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe cilësisë së jetës për fëmijet me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. |              |              |              |
| <b>1.1.A.</b> | <b>Produkti</b>                           |  |              |              |              |
|               | <i>Kodi i Projektit</i>                   |  |              |              |              |
|               | Përshkrimi i Produktit:                   | Mbeshtetje ekonomike për familjet  |              |              |              |
|               | Njësia Matëse                             | 50 fëmije  |              |              |              |
|               |   | <b>2022</b>  | <b>2023</b>  | <b>2024</b>  | <b>2025</b>  |
|               |   | <b>Buxheti</b>   | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> |
|               | Sasia                                     | 45   | 50           |              |              |
|               | Kosto totale (në mijë lekë)               | 500.0  | 500          |              |              |
|               | Kosto për njësi (në mijë lekë)            | 11.1   | 10.0         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i Sasisë                   |  | 10.0%        |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston totale            |  | 0.0%         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston për njësi         |  | -9.9%        |              |              |
| <b>1.1.B.</b> | <b>Produkti</b>                           |  |              |              |              |
|               | <i>Kodi i Projektit</i>                   |  |              |              |              |
|               | Përshkrimi i Produktit:                   | pagat dhe sigurime   |              |              |              |
|               | Njësia Matëse                             | 5 numer  |              |              |              |
|               |   | <b>2022</b>  | <b>2023</b>  | <b>2024</b>  | <b>2025</b>  |
|               |   | <b>Buxheti</b>   | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> |
|               | Sasia                                     | 5  | 5            |              |              |
|               | Kosto totale (në mijë lekë)               | 632.0  | 632          |              |              |
|               | Kosto për njësi (në mijë lekë)            | 126.4  | 126.4        |              |              |
|               | Ndryshimi në % i Sasisë                   |  | 0.0%         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston totale            |  | 0.0%         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston për njësi         |  | 0.0%         |              |              |
| <b>1.1.C.</b> | <b>Produkti</b>                           |  |              |              |              |
|               | <i>Kodi i Projektit</i>                   |  |              |              |              |
|               | Përshkrimi i Produktit:                   | Trajnimi i stafi (pages lektori)   |              |              |              |
|               | Njësia Matëse                             | 1 numer  |              |              |              |
|               |   | <b>2022</b>  | <b>2023</b>  | <b>2024</b>  | <b>2025</b>  |
|               |   | <b>Buxheti</b>   |              | <b>Plani</b> | <b>Plani</b> |
|               | Sasia                                     | 1  | 1            |              |              |
|               | Kosto totale (në mijë lekë)               | 40.0   | 40           |              |              |
|               | Kosto për njësi (në mijë lekë)            | 40.0   | 40.0         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i Sasisë                   |  | 0.0%         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston totale            |  | 0.0%         |              |              |
|               | Ndryshimi në % i koston për njësi         |  | 0.0%         |              |              |

|                                  |                                 |                                  |  |
|----------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|--|
| <b>Kryetari i NJVV</b>           | <b>Kordinatori i GMS</b>        | <b>Drejtuesi i Programit</b>     |  |
| Emri Mbiemri: <i>[Signature]</i> | Emri Mbiemri: <i>Eveda Maja</i> | Emri Mbiemri: <i>Marte Fetaj</i> |  |
| Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>   | Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>  | Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>   |  |
| Datë:                            | Datë:                           | Datë:                            |  |







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Preventiv I shpenzimeve te projektit  
"Sherbimi lezves per femijet me aftesi te kufizuar, "Tungjatjeta..jete", Bashkia Lezhe, per vitin 2023

| No.        | Cost Items   | Njësia (p.sh. pjesë, orë pune / ditë, muaji i personit, muaji, viti, përmbledhje) | Sasia | Kosto për njësi / Lek | Kosto Total /lek   | Kontributi i kërkuar nga Fondi Social |
|------------|--|---|-------|-----------------------|--------------------|---------------------------------------|
|            | <b>Sub total-1</b>                                       |   |       |                       |                    |                                       |
| <b>I</b>   | <b>Paga dhe sigurime per stafin e projektit</b>          |   |       |                       |                    |                                       |
| <b>I.1</b> | <b>Paga</b>  | 5   | 12    | 45,100.0              | 542,000.0          | 542,000.0                             |
| <b>I.2</b> | <b>Sigurime</b>  | 5   | 12    | 7,500.0               | 90,000.0           | 90,000.0                              |
|            | <b>Sub total -2</b>                                      |   |       | <b>52,600.0</b>       | <b>632,000.0</b>   | <b>632,000.0</b>                      |
| <b>3</b>   | <b>Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)</b> |   |       |                       |                    |                                       |
| <b>3.4</b> | <b>Mbeshetje ekonomike per familjaret e projektit</b>    | 40  | 40    | 12,500.0              | 500,000.0          | 500,000.0                             |
| <b>3.6</b> | <b>Trajnim per stafin e projektit</b>                    | 1   | 1     | 40,000.0              | 40,000.0           | 40,000.0                              |
|            | <b>Sub total - 3</b>                                     |   |       | <b>52,500.0</b>       | <b>540,000.0</b>   | <b>540,000.0</b>                      |
|            | <b>TOTAL</b>   |   |       | <b>105,100.0</b>      | <b>1,172,000.0</b> | <b>1,172,000.0</b>                    |

Konc: Desara Marku

Drejtori i sherbimit dhe Kujdesit social  
Marte Fetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE  
SOCIALE TË INTEGRUARA  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr 4957 Prot

Tiranë, më 30.12 2022

Lënda: Njoftim

BASHKISË LEZHË ✓

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përmbushje të detyrimeve ligjore, për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave, për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka miratuar vijimin e financimit për vitin e katërt të ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror "Shërbimi Lëvizës - Tungjatjeta Jetë" për fëmijët me aftësi të kufizuar" në bashkinë Lezhë, në kuadër të Fondit Social për vitin 2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023, do të financojë vijimin e ofrimit të shërbimit në vitin e katërt, në masën 30% të kostos, në vlerën 1,172,000 lekë.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financiar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit kërkohet nga ana Juaj, raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

JOANA DUBO







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 48/3 Prot.

Tiranë, më 11/01 / 2023

**Lënda:** Transferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në qarqe dhe bashki.

**SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR  
TIRANË**

**KËSHILLIT TË QARKUT TIRANË, ELBASAN, GJIROKASTËR, SHKODËR  
BERAT, VLORË**

**BASHKISË ELBASAN, VLORË, GJIROKASTËR, SHKODËR, RROGOZHINË,  
DELVINË, LIBRAZHD, KORÇË, KUKËS, LEZHË, PATOS, DURRËS**

**DEGËS SË THESARIT**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 105, gërma C si dhe shkresës së Shërbimit Social Shtetëror nr. 271, datë 10.01.2023, bashkëlidhur gjeni transferimin e fondit për financimin e shërbimeve të përkujdesit në qarqe dhe bashki.

Duke ju falenderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**JOANA DURO**



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Transferim fondi për qendrat e përkujdesit në qarqe dhe bashki-ID6748467

Tabela 1(plan Buxheti)

| Enti Qeveris es | Gr 13 | Kod I Institucionit | Emer Institucionit            | Kapitulli | Programi | Artikulli | Kodi i deges se thesarit | Kodi i projektit | Debiti Vjetor      |
|-----------------|-------|---------------------|-------------------------------|-----------|----------|-----------|--------------------------|------------------|--------------------|
|                 |       |                     | <b>SHTESA</b>                 |           |          |           |                          |                  | <b>145,110,817</b> |
| 035             | 13    | 2035001             | Këshilli I Qarkut Tiranë      | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3535             | 46,217,742         |
| 048             | 13    | 2048001             | Këshilli I Qarkut Elbasan     | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0808             | 22,141,794         |
| 109             | 13    | 2109001             | Elbasan                       | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0808             | 4,343,945          |
| 011             | 13    | 2011001             | Këshilli I Qarkut Gjirokastrë | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 1111             | 11,710,674         |
| 033             | 13    | 2033001             | Këshilli I Qarkut Shkodër     | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3333             | 6,047,417          |
| 042             | 13    | 2042001             | Këshilli I Qarkut Berat       | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0202             | 9,401,724          |
| 037             | 13    | 2037001             | Këshilli I qarkut vlorë       | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3737             | 9,499,501          |
| 146             | 13    | 2146001             | Vlorë                         | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3737             | 6,278,524          |
| 122             | 13    | 2122001             | Korçë                         | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 1515             | 3,946,724          |
| 119             | 13    | 2119001             | Rrogozhinë                    | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3513             | 2,192,016          |
| 125             | 13    | 2125001             | Kukës                         | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 1818             | 1,665,506          |
| 112             | 13    | 2112001             | Patos                         | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0909             | 1,244,000          |
| 104             | 13    | 2104001             | Delvinë                       | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3705             | 2,609,800          |
| 141             | 13    | 2141001             | Shkodër                       | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3333             | 8,612,016          |
| 107             | 13    | 2107001             | Durrës                        | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0707             | 3,536,784          |
| 115             | 13    | 2115001             | Gjirokastrë                   | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 1111             | 1,987,018          |
| 127             | 13    | 2127001             | Lezhë                         | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 2020             | 1,172,000          |
| 128             | 13    | 2128001             | Librazhd                      | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 0821             | 2,503,632          |
|                 |       |                     | <b>PAKES/ME</b>               |           |          |           |                          |                  | <b>145,110,817</b> |
| 001             | 13    | 1013141             | Administrata e SHSSH          | 01        | 10430    | 6060000   | 91307AH                  | 3535             | 145,110,817        |

Tabela 2(plan-Theasari)

| Muaji  | Enti Qeveris es | Gr 13 | Kod I Institucionit | Emer Institucionit            | Kapitulli | Programi | Artikulli | Kodi i projektit | Kodi i deges se thesarit | Debiti Vjetor      |
|--------|-----------------|-------|---------------------|-------------------------------|-----------|----------|-----------|------------------|--------------------------|--------------------|
|        |                 |       |                     | <b>SHTESA</b>                 |           |          |           |                  |                          | <b>145,110,817</b> |
| Jan-23 | 035             | 13    | 2035001             | Këshilli I Qarkut Tiranë      | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 3535                     | 46,217,742         |
| Jan-23 | 048             | 13    | 2048001             | Këshilli I Qarkut Elbasan     | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 0808                     | 22,141,794         |
| Jan-23 | 109             | 13    | 2109001             | Elbasan                       | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 0808                     | 4,343,945          |
| Jan-23 | 011             | 13    | 2011001             | Këshilli I Qarkut Gjirokastrë | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 1111                     | 11,710,674         |
| Jan-23 | 033             | 13    | 2033001             | Këshilli I Qarkut Shkodër     | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 3333                     | 6,047,417          |
| Jan-23 | 042             | 13    | 2042001             | Këshilli I Qarkut Berat       | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 0202                     | 9,401,724          |
| Jan-23 | 037             | 13    | 2037001             | Këshilli I qarkut vlorë       | 01        | 10430    | 6029999   |                  | 3737                     | 9,499,501          |



| Enti Qeveris es | Gr 13 | Kod I Institucionit | Emer Institucionit   | Kapitulli | Programi | Artikulli | Kodi i degesse thesarit | Kodi i projektit | Debiti Vjetor      |
|-----------------|-------|---------------------|----------------------|-----------|----------|-----------|-------------------------|------------------|--------------------|
| Jan-23          | 13    | 2146001             | Vlorë                | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 3737             | 6,278,524          |
| Jan-23          | 13    | 2122001             | Korçë                | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 1515             | 3,946,724          |
| Jan-23          | 13    | 2119001             | Rrogozhinë           | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 3513             | 2,192,016          |
| Jan-23          | 13    | 2125001             | Kukës                | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 1818             | 1,665,506          |
| Jan-23          | 13    | 2112001             | Patos                | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 0909             | 1,244,000          |
| Jan-23          | 13    | 2104001             | Delvinë              | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 3705             | 2,609,800          |
| Jan-23          | 13    | 2141001             | Shkodër              | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 3333             | 8,612,016          |
| Jan-23          | 13    | 2107001             | Durrës               | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 0707             | 3,536,784          |
| Jan-23          | 13    | 2115001             | Gjirokastrë          | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 1111             | 1,987,018          |
| Jan-23          | 13    | 2127001             | Lezhë                | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 2020             | 1,172,000          |
| Jan-23          | 13    | 2128001             | Librazhd             | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 0821             | 2,503,632          |
|                 |       |                     | <b>PAKESIME</b>      |           |          |           |                         |                  | <b>145,110,817</b> |
| Jan-23          | 001   | 1013141             | Administrata e SHSSH | 01        | 10430    | 6029999   |                         | 3535             | 145,110,817        |